

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË GJUHËVE TË HUAJA

1.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Anglisht, klasa 3-B, me temë mësimore ‘Day by Day’, dhe me koncept kryesor ‘Adverbs of Frequency’, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit/ose pjesa më e madhe e nxënësve të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 5 grupe me nga 4 nxënës për secilin grup. Të gjithë nxënësit janë të ulur përballë njëri tjetrit në mënyrë që të bashkëveprojnë. Kam bashkuar dy banka në mënyrë që nxënësit të ndihen komod gjatë punimeve. Grupimet janë të rastësishme dhe me nivele të ndryshëm, në mënyrë që të ketë efikasitet në të nxënë dhe organizim.
- Informova klasën në lidhje me aktivitetin që do të zhvillojnë dhe qëllimin e tij (Përdorimi i Adverbs of Frequency).
- Temat në të cilat do të punojnë nxënësit i kam vendosur brenda disa letrave të vogla dhe i kam mbyllur. Nxënësit duhet të zgjedhin nga një letër për secilin grup.
- Pasi është bërë përzgjedhja, mësuesja u jep shpjegime secilit grup për punën që duhet të bëjnë, ku nxënësit do ta realizojnë punën në fletoren e klasës. Gjithë secili ka fletoren e vet specifike.
- Nxënësit do të fillojnë të bashkëbisedojnë me njëri tjetrin në mënyrë që të realizojnë detyrën. Secili nga ato do të shkruajë nga dy fjali për secilën ‘Adverb of Frequency’ (Always, Sometimes, Never).
- Mësuesja i shikon të gjithë grupet nga afër në mënyrë që t’i ndihmojë, kur ato ta pyesin.
- Pas një kohë të dhënë për të punuar, nxënësit do të bëhen gati për t’u përgjigjur. Mësuesja ju kërkon nxënësve që të jenë të vëmendshëm.
- Fillon të lexuarit me një grup të rastësishëm dhe ndiqet gjithashtu leximi zinxhir. Çdo nxënës do të lexojë fjalitë e tij. Ky model do të ndiqet për të gjitha grupet në vazhdim.
- Mësuesja shkon pranë çdo grupi që të kontrollojë përgjigjet.
- Në këtë veprimtari nxënësit punuan të pavarur, por njëkohësisht duke u angazhuar të gjithë. Gjithashtu dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, veprimtari kjo e cila zgjati rreth 15 minuta.

Në përfundim të veprimtarisë u vu re që secili/a nxënës/e arriti të krijojë fjalitë bashkë me strukturën e saktë përkatëse. Ato gjithashtu në bazë të temave të ndryshme, arrijnë të lidhin këtë pjesë të gramatikës me jetën e përditshme. Koncepti u përvetësua plotësisht. Metoda e punës në grupë ndihmon në krijimin e një atmosfere gjithëpërfshirëse.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shumë sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Solingena Selimi

solingena.selimi@gmail.com

2.METODA “PUNË NË GRUPE-LEARN BY DOING”

Në orën mësimore të lëndës ‘Mathematics’, klasa 3C, me temë mësimore ‘3D shapes’ dhe me koncepte kryesore emërtimin e trupave gjeometrikë, gjetjen e veçorive të tyre dhe dallimin ndërmjet prizmave dhe piramidave, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore “Punë në grupe heterogjene-Learn by doing” më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda/teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Informova nxënësit për aktivitetin që do të zhvillohet dhe qëllimin e tij (ndërtimi i trupit gjeometrik me kunjë dhëmbësh dhe plastelinë, prizëm/piramidë, të ndryshme për grupe të ndryshme dhe identifikimi dhe numërimi i veçorive për atë trup gjeometrik-faqe, brinjë, kulme)
- Demonstrua aktivitetin. Zgjodha një kartë, lexova emrin e trupit gjeometrik dhe fillova ndërtimin e tij me kunjë dhëmbësh dhe plastelinë. Më pas plotësova tabelën me veçoritë e atij trupi gjeometrik-faqe, brinjë, kulme.
- U kërkova nxënësve të bëhen në grupe katërshe (treshe në rast mungesash) . Nxënësit e bankave të para dhe të treta kthehen pas. U dhashë udhëzimet dhe me ndihmën e disa nxënësve shpërndava materialet e nevojshme (karta ku shënohet emri i trupit gjeometrik dhe tabela me veçoritë, të cilat duhen plotësuar pas ndërtimit të trupit gjeometrik, kunjat e dhëmbëve dhe plastelinë) .
- Nxënësit filluan punën e pavarur në grupet e tyre ndërsa unë monitoroja procesin në secilin grup, duke përgëzuar dhe inkurajuar nxënësit në çdo moment dhe sigurohem që të ketë gjithëpërfshirje. Këmbëngul që nxënësit jo vetëm të plotësojnë tabelën me veçoritë e trupave gjeometrikë, por për nxënësit që hasin vështirësi, të më demonstrojnë cilat janë faqet, brinjët dhe kulmet duke i prekur ato.
- Bëra pyetje në secilin grup për të nxitur komunikimin me terminologji matematikore në gjuhën angleze dhe duke i nxitur të mësojnë të arsyetojnë zgjedhjet dhe veprimet e tyre p.sh. “Unë: Do të ndërtoni një prizëm gjashtëkëndor apo një piramidë gjashtëkëndore? Nxënësit: Nje prizëm gjashtëkëndor. Une: Kuptoj. Do të ndërtoni një prizëm gjashtëkëndor prandaj po ndërtoni dy gjashtëkëndësha.”
- Grupet të cilat mbarojnë detyrën më herët se grupet e tjera, vazhdojnë me ndërtimin e trupave të tjerë gjeometrikë deri sa të mbarojë koha e vënë në dispozicion për këtë aktivitet (15 min) .
- Në përfundim të aktivitetit pyes nxënësit për karakteristikat e prizmave dhe karakteristikat e piramidave, kush e përcakton emrin e prizmit dhe kush e përcakton emrin e piramidës. Përgëzoj nxënësit.

Nga ky aktivitet u vu re që rezultatet e të nxënit që ishin vendosur për ato koncepte të orës mësimore, ishin arritur plotësisht nga të gjithë nxënësit.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe, të kombinuar dhe të përshtatur në mënyra nga më të ndryshmet me lojra e aktivitete, sepse krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Elda Memishaj

elda.memishaj@gea.edu.al

3.METODA “DRAMATIZIM NË PUNËN ME GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës gjuhës angleze, klasa 1c me temë mësimore ‘My new house’ dhe me koncept kryesor përdorimi i fjalorit dhe komunikimi në gjuhën angleze, me anë të fjalëve të tekstit. Dramatizimi në punën në grupe më mundësoi përfshirjen në mënyrë aktive dhe të plotë të të gjithë nxënësve të klasës edhe iu hoqi pasiguritë e tyre. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Informoj nxënësit për aktivitetin e përgatitur që do të zhvillohet në klasë, duke marrë parasysh qëllimin që po përdoret kjo metodë.
- Nxënësit informohen në lidhje me rregullat e aktivitetit që do të zhvillohet hap pas hapi. Ato do të ilustrojnë fjalët e tekstit duke përdorur maskat përgatitura nga vetë ato. Kjo i lejon nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur si fillim dhe me pas t’i bashkohen një qëllimi, që grupi të dramatizoj në mënyrë të saktë dhe kështu të dali grupi fitues.
- Si fillim unë vendos në *smatboard* pjesën filmike dhe nxënësit e shikojnë atë. Më pas, i pyes për secilin personazh dhe ato të mund të përmendin emrat e tyre në gjuhës Angleze.
- Unë i ndaj nxënësit në 3 grupe (A,B,C), ku secili grup është i përbërë nga 7 nxënës. Ndarja e grupeve bëhet në mënyrë të rastësishme, me nxënës të niveleve të ndryshme. Secilit grup i kërkohet të zgjedhë cilin rol ato dëshirojnë të mësojnë .
- U shpjegoj nxënësve që, në bazë të rolit të zgjedhur, ata do të ritregojnë fjalët e personazhit.Nxënësit zgjedhin sipas dëshirës personazhin e parapëlqyer. Kur të gjithë nxënësit e 3 grupeve pajisen me maskat, fillohet loja.
- Në bazë të renditjes së pjesës, nxënësit fillojnë, sipas një rradhe, të dramatizojnë në role pjesën e tekstit.
- Nxënësit të cilët gjatë dramatizimit bëjnë sa më pak gabime në të folur dhe performojnë bukur pjesën do të shpallen si fitues, së bashku me grupin e tyre.
- Sakaq nxënësit e tjerë, dëgjojnë me vëmendje grupin që performon dhe përsërisin bashkë me to rolin e tyre përkatës.
- Kjo formë organizimi siguroi një gjithëpërfshirje të nxënësve dhe një orë dramatizimi në gjuhën angleze, që mësohet dhe reflektohet në të duke u argëtuar në të njëjtën kohë. Ky aktivitet zgjati 20 minuta dhe në fund të lojës dolën fitues të tre grupet.

Në përfundim të aktivitetit nxënësit morën pikë vlerësuese dhe bënë foto me maskat e personazheve.Përdorimi i punës në role është mënyra më e mirë që nxënësit të tregojnë gjithëpërfshirje dhe përvetësim njohurish në mënyrë efektive dhe argëtuese.

Mësuesja: Bajame Kamberi

bajame.kamberi@gea.edu.al

4.METODA “GAMIFICATION NË PLATFORMËN ‘KAHOT’”

Në orët mësimore të klasës e IX shpesh përdor ‘Gamification në platformën Kahot’ në mësimin e gjuhës së huaj, e cila përfshin integrimin e elementeve të lojës, nxit të menduarit në procesin e të nxënësve, duke e bërë atë më tërheqës, motivues dhe të efektshëm. Duke përdorur elemente të ngjashme me lojën si: Pikët, nivelet, shpërblimet dhe konkurrencën, nxënësit nxitën

të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të memorizojnë informacionin më lehtë. U përzgjedh 'Platforma Kahoot' për të përforcuar njohuritë mbi përdorimin e foljeve modale me klasën e IX.

Kahoot! është një platformë mësimore e bazuar në lojëra në internet që lejon mësuesit dhe nxënësit të krijojnë dhe të marrin pjesë në kuize, sondazhe dhe diskutime. Përdoret gjerësisht për mësimin e lojërave dhe mund të konsiderohet një mjet efikas për mësimin e gjuhës së huaj dhe jo vetëm.

Si punohet me platformën **Kahoot!**?

1. Krijimi i kuizeve: Mësuesit dhe nxënësit mund të krijojnë kuize me pyetje me zgjedhje të shumëfishta, të vërteta/të gabuara ose me përgjigje të shkurtra, ku mund të përfshihen imazhe, video dhe tinguj për t'i bërë pyetjet më tërheqëse.

2. Lojërat: Pasi një kuiz të jetë gati, nxënësit bashkohen duke përdorur një kod unik loje. Ata u përgjigjen pyetjeve në kohë reale në pajisjet e tyre (smartphone, tabletë ose kompjuter).

3. Pikët dhe tabelat: Lojtarët fitojnë pikë për përgjigjet e sakta dhe sa më shpejt të përgjigjen, aq më shumë pikë marrin. Pas çdo pyetjeje, shfaqet një tabelë fituesish, e cila tregon golashënuesit më të mirë.

4. Live ose Self-Paced: Kahoot! mund të luhet drejtpërdrejt në klasë ose të caktohet si një sfidë me ritëm të pavarur ku Mësuesit dhe nxënësit i përgjigjen pyetjeve në kohën e tyre.

Përfitimet e përdorimit të 'Kahoot' në mësimin e gjuhës:

- **Gjithëpërfshirja:** 'Kahoot' e kthen praktikën gjuhësore në një garë argëtuese, e cila rrit angazhimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- **Reagime të menjëhershme:** Nxënësit marrin reagime të menjëhershme për përgjigjet e tyre, duke i ndihmuar ata të identifikojnë fushat për përmirësim.
- **Përforcimi i të nxënësve:** Duke përsëritur fjalorin ose gramatikën nëpër runde të shumta, nxënësit përforcojnë atë që kanë mësuar.
- **Motivimi:** Sistemi i pikëve, tabela e drejtuesve dhe konkurrenca i mbajnë nxënësit të motivuar për të performuar më mirë, gjë që mund të rrisë rezultatet e të nxënësve.
- **Ndërveprimi social:** Kahoot mund të përdoret për kuize në grup, duke i inkurajuar nxënësit të bashkëpunojnë dhe të mësojnë së bashku.

Si të përdorni 'Kahoot' për mësimin e gjuhës?

- **Kuizet e fjalorit:** Krijoni kuize mbi fjalët e reja të fjalorit, ku nxënësit duhet të përputhen me përkufizimet me fjalën e duhur, ose të përkthejnë fjalë midis gjuhës së synuar dhe gjuhës së tyre amtare.
- **Praktika gramatikore:** Hartoni kuize që fokusohen në tema specifike gramatikore si p.sh. konjugimi i foljeve, struktura e fjalisë ose marrëveshja mbiemër-mbiemër.
- **Kuptimi i të dëgjuarit:** Përfshini videoklipe me fjalë ose fjali që studentët të dëgjojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve bazuar në atë që dëgjojnë.

- ***Ndërgjegjësimi kulturor:*** Përdor 'Kahoot' për të testuar njohuritë e nxënësve për kulturën që lidhet me gjuhën që ata mësojnë (p.sh. fakte rreth vendeve, traditave ose njerëzve të famshëm).
- ***Spelling Bees:*** Krijoni kuize drejtshkrimore për t'i ndihmuar nxënësit të përmirësojnë drejtshkrimin e tyre në gjuhën e synuar.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që t'i përdorin sa më shpesh metodën 'Gamification me platformën Kahoot', sepse arrijnë të krijojnë një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Silvana Daci

s.daci@gea.edu.al